



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. 6295 Prot

Fier më 18 05/2026

PROJEKT VENDIM

NR. 412 dt. 18 05/2026

Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të apartamentit për familjen e shtetasit Todi Sili Llagone , pasuri e paluajtshme e cila ka mbetur pa u regjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për lidhjen e Kontratës para noterit publik.

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më dt. ___/03/2026, I paraqitet për shqyrtim materiali nga Drejtoria Juridike, mbi kërkesën zyrtare të familjes Todi Sili Llagone , e cila kërkon përfundimin e procedurave të privatizimit të apartamentit të privatizuar , për shkak se ka mbetur pa u regjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, (ish ZVRPP Fier) për shkak të lidhjes së kontratës së privatizimit para noterit publik . Dokumentacioni ligjor I privatizimit u është vënë në dispozicion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës , Drejtoria Vendore Fier në formën fotokopje njehsuar me origjinalin si dhe është plotësuar me dokumentacionin ligjor të rifreskuar , dorëzuar mbi bazën e kërkesës zyrtare pranë Bashkisë Fier me Nr.384 Prot , datë 13/01/2026.

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 97 date 03.02.2008 " Per procedurat e privatizimit te banesave shteterore objekt i ligjit nr. 7652 date 23.12.1992 dhe ligjit nr. 9321 date 25.11.2004 "Per trajtimin e banesave dhe objekteve te kthyer ne banesa me fondet e Shoqerive dhe Ndermarrjeve Shteterore " dispozitave ligjore nenet 192,193 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë , si dhe Ligjin Nr.111/ 2018 “ Për Kadastrën “, ekzekutivi,

Propozon:

1. Të miratojë përfundimin e procedurave të privatizimit të apartamentit, për familjen e shtetasit Todi Sili Llagone, përkatesisht lidhjen e kontratës së shitblerjes para noterit publik për apartamentin i cili ka mbetur pa u regjistruar pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, apartament me të dhënat sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme si më poshtë:

Nr.	Emër-Mbiemër	Të dhënat e pasurisë / Adresa
1.	Todi Sili Llagone	Kartela e Pasurisë së paluajtshme Nr.i Pasurisë 3/4+3-22, Iloji “Apartament “,ZK Nr.8533, Lagjija “ 8 Shkurti”, përbërje ap 2+1 , sip.74.1 m2 .

2. Shpenzimet noteriale dhe tarifat për kryerjen e veprimeve të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës , Drejtoria Vendore , do të kryhen nga familja përfituese;
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Fier, ose personi i autorizuar prej tij, për lidhjen e kontratës para noterit publik.

Konc.Drejtoria Juridike
Esmeralda Kapllanaj

KRYETARI
Armando Subashi

NË MUNGESË E ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARE

Mirela Pitushi

